


## Pyjet - tranzicioni i paqëndrueshëm i një sektori

Më 27 janar 2025, me rastin e 102 vjetorit të Shërbimit Pyjor Shqiptar dhe 65 vjetorit të krijimit të Fakultetit të Pyjeve, në mjediset e Fakultetit të Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës, u promovua libri “Pyjet-tranzicioni i paqëndrueshëm i një sektori” i autoreve K. Malaj, G. Kacori, G. Kromidha dhe E. Toromani.


Bazuar gjerësisht në informacionet dhe të dhënat e marra nga studimi “Pyjet në tranzicion” përgatitur nga Qendra AlbaForest me financim të REC Shqipëri, për periudhën 1992-2014, dhe libri “Pyjet në rrjedhën e një shekulli” shkruar nga Irfan Meko dhe Genci Kacori, për periudhën 2015-2022, libri, botuar nga Shoqata e Specialistëve të Pyjeve, me mbështetjen financiare të CNVP, hedh një vështrim kritik mbi zhvillimet në sektorin e pyjeve gjatë periudhës së tranzicionit (1991-2024), duke nxjerrë në pah, në mënyrë objektive, shkaqet apo arsyet, që kanë çuar në situatën kritike ku ndodhet sot sektori i pyjeve.

Në një lexim transversal libri përpiket të argumentojë paqëndrueshmërinë e sektorit të pyjeve në disa drejtime kryesore. Më poshtë do të ndalemi kryesisht tek paqëndrueshmëria e menaxhimit të burimeve pyjore, paqëndrueshmëria e strukturave dhe keqpërdorimi i mbështetjes bujare të donatoreve të huaj për sektorin e pyjeve.

Gjatë dekadave të fundit, sektori i pyjeve ka përjetuar ndryshime të sipërfaqes dhe reduktim të vëllimit të fondit pyjor. Që nga fundi i viteve 1990, pyjet janë degraduar rëndë kryesisht për shkak të operacioneve të paqëndrueshme dhe shpesh të paligjshme të prerjes së pyjeve, por edhe për shkak të zjarreve në pyje. Krahasimi i të dhënave të inventarëve të pyjeve realizuar gjatë




periudhës së tranzicionit tregon humbje të volumit drusor në masën 28.4 milion m<sup>3</sup> ose 1/3 e vëllimit të pyjeve në vitin 1985. Volumi i humbur u përket përgjithësisht trungishteve.



Problematikë e rëndësishme është edhe mos pasqyrimi koherent i humbjeve të volumit drusor në statistikat e sektorit të pyjeve, duke i dhënë shkas rezultateve të pabesueshme. P.sh., në vitin 2015 volumi drusor i fondit pyjor në Shqipëri është pakësuar me afërsisht 21 milion m<sup>3</sup>. Asnjë katastrofë natyrore apo shkatërrim masiv i pyjeve nuk ka ndodhur në këtë vit. Deri në vitin 2011, sasitë e shfrytëzuara nga familjet

rurale për ngrohje e gatim nuk raportoheshin fare, por edhe në vitet e tjera raportimi është shumë larg sasive reale të marra nga pyjet.

Në fillim të viteve '90 strukturat e administrimit të pyjeve sapo kishin dalë nga Ministria e Bujqësisë dhe filluan të krijonin fizionominë dhe kapacitetet e pavarura, çka kulmoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave e cila në periudhën 2000-2005 numëronte një personel prej 50 vetash në zyrat qendrore dhe mbi 1000 vetë në Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe.



Pas vitit 2005, kur sektori i pyjeve kalon nën Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, strukturat e administrimit të pyjeve u reduktuan vazhdimisht, duke përfunduar aktualisht në një sektor brenda Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me një personel prej 3 vetash. Ndërkohë duhet përmendur edhe krijimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në 2015 dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve në 2020. Të dy këto institucione kanë përgjegjësi të ndryshme dhe shpesh të mbivendosura lidhur me administrimin e burimeve pyjore në Shqipëri.

Gjatë periudhës së tranzicionit janë miratuar tre ligje specifike për sektorin e pyjeve (Ligji nr. 7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor” (ndryshuar); Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” (ndryshuar); Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”) por ende nuk mund të thuhet se kuadri ligjor është i plotë dhe në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane të menaxhimit të burimeve pyjore.

Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe janë miratuar edhe dy dokumente të rëndësishme strategjike për zhvillimin e sektorit të pyjeve me qëllim mbrojtjen e burimeve natyrore dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm (Strategjia kombëtare e zhvillimit dhe reformës institucionale në sektorin e pyjeve dhe kullotave (2004); Dokumenti i politikave për pyjet, për periudhën 2019-2030 (2018)) por rekomandimet dhe masat e parashikuara në to nuk janë zbatuar asnjëherë.

Transferimi në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike (2016) ishte një tjetër lëvizje drejt paqëndrueshmërisë së sektorit. Aktualisht bashkitë menaxhojnë rreth 80% të pyjeve në Shqipëri, por në shumë prej tyre mungojnë gjerësisht kapacitetet dhe burimet për të menaxhuar siç duhet burimet pyjore.

Zbatimi i dobët i Moratoriumi të shfrytëzimit të pyjeve në Republikën e Shqipërisë (2016) dhe mungesa e rezultateve në luftën kundër praktikave të paligjshme brenda sektorit është një pengesë kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori. Nga ana tjetër, mungesa e investimeve në


infrastrukturë, teknologji dhe kapacitete njerëzore kufizon ndejshëm mundësitë për zhvillime në sektor.

Ndërkohe, gjatë periudhës së tranzicionit sektori ka gëzuar mbështetjen e rëndësishme të disa donatorëve, në projekte madhore e afatgjata ndër të cilët mund të përmendim:

- Projekti i Pyjeve (PP) (Vlera: 21,7 milionë USD; Donatorë: Banka Botërore dhe Qeveria Italiane)
- Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN) (Vlera: 19.4 milionë USD; Donatorë: Qeveria Shqiptare, IDA, Fondi Global për Mjedisin (GEF) dhe Sida)
- Projekti i Shërbimeve Mjedisore (Vlera: 17.6 milionë EUR; Donatorë: Banka Botërore, Qeveria Suedeze dhe Fondi Global për Mjedisin (GEF))

Mbështetja e donatoreve ka qenë thelbësore në buxhetin e sektorit të pyjeve pasi plotësonte boshllëkun në nevojat për investime, të cilat nuk plotësoheshin nga buxheti i shtetit, i cili mbulonte kryesisht pagat dhe shpenzimet operative.

Miratimi i ligjit nr. 8302, datë 12.3.1998 “Për administrimin e të ardhurave që krijohen në pyje dhe kullota - pasuri shtetërore”, krijoi mundësi reale për realizimin e investimeve nga të ardhurat e vetë sektorit.



Në përfundim libri nënvizon faktin se pas një tranzicioni të vështirë e të paqëndrueshëm, sektori i pyjeve sot përballët me burime pyjore të degraduara, kudër institucional të mangët dhe zbehje e rolit të specialistit të pyjeve.

Kjo në një kohë kur pyjet vazhdojnë të luajnë rol thelbësor në zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin rural dhe shumica e pyjeve dhe kullotave menaxhohen nga Bashki që nuk kanë kapacitetet e duhura njerëzore e financiare.